


Makinë larëse

Udhëzim për përdorim

Mašina za pranje veša

Uputstvo za upotrebu



WMY 71233LMB3

SQ / SB

Numri i Dokumentit= 2820524924_SQ/30-01-17.(14:12)

beko



Ky produkt është prodhuar duke përdorur teknologjinë më të fundit në kushte të favorshme me mjedisin.

1 Udhëzimet e përgjithshme të sigurisë

Kjo pjesë përfshin udhëzimet e sigurisë të cilat mund të ndihmojnë për të parandaluar dëmtimet dhe rreziqet e dëmtimeve materiale. Të gjitha llojet e garancive do të jenë të pavlefshme nëse nuk zbatohen këto udhëzime.

1.1 Siguria e jetës dhe pronës

- ▶ Mos e vendosni kurrë produktin në një dyshe të mbuluar me tapet. Pjesët elektrike do të nxehen tepër meqenëse ajri nuk mund të qarkullojë poshtë pajisjes. Kjo do të shkaktojë probleme me produktin tuaj.
- ▶ Hiqeni produktin nga priza nëse nuk përdoret.
- ▶ Instalimin dhe procedurat e riparimit bëjini gjithmonë nga Agjenti i Autorizuar i Shërbimit. Prodhuesi nuk do të mbajë përgjegjësi për dëmtime që mund të bëhen nga procedura të kryera nga persona të paautorizuar.
- ▶ Furnizimi me ujë dhe tubat e shkarkimit duhet të jenë të lidhura në mënyrë të sigurt dhe të mos dëmtohen. Përndryshe mund të ndodhë rrjedhje uji.
- ▶ Ndërkohë që ka akoma ujë brenda produktit, mos e hapni asnjëherë derën e ngarkimit ose mos e hiqeni filtrin. Përndryshe, mund të ketë rrezik përmbytjeje apo lëndim nga uji i nxehtë.
- ▶ Mos e hapni me forcë derën e ngarkimit kur është e kyçur. Dera mund të hapet pak minuta pasi të ketë mbaruar cikli i larjes. Në rast se dera e ngarkimit hapet me forcë, dera dhe mekanizmi i kyçjes mund të dëmtohen.
- ▶ Përdorni detergjente, zbutës apo suplemente të përshtatshme vetëm për makinat larëse automatike.
- ▶ Ndiqni udhëzimet në etiketën e rrobave dhe në paketimin e detergjentit.

1.2 Siguria për fëmijët

- ▶ Ky produkt mund të përdoret nga fëmijët të cilët janë të moshës 8 e sipër dhe nga njerëzit aftësitë fizike, ndjesore ose mendore të të cilëve nuk janë të zhvilluara plotësisht ose që nuk kanë eksperiencën dhe njohurinë e nevojshme për sa kohë janë të mbikëqyrur ose të stërvitur për përdorimin e sigurt të produktit dhe rreziqet e tij. Fëmijët nuk duhet të luajnë me pajisjen. Nuk duhet të kryhen punë pastruese apo për mirëmbajtjen nga ana e fëmijëve përveç rasteve kur ata janë të mbikëqyrur nga dikush. Fëmijët nën moshën 3 vjeç duhet të mbahen larg përveç nëse mbikëqyren vazhdimisht.
- ▶ Materialet e paketimit mund të jenë të rrezikshme për fëmijët. Ruajini materialet paketuese në një vend të sigurt ku fëmijët nuk mund t'i kapin.
- ▶ Produktet elektrike janë të rrezikshme për fëmijët. Mbajini fëmijët larg produktit kur është në punë. Mos i lejonit të luajnë me produktin. Përdorni kyçjen për fëmijët për t'i parandaluar fëmijët që të ndërhyjnë në punën e produktit.

- ▶ Mos harroni të mbyllni derën e ngarkimit kur largoheni nga dhoma ku ndodhet produkti.
- ▶ Ruajini të gjithë detergjentet dhe aditivët në një vend të sigurt ku fëmijët nuk mund t'i kapin duke mbyllur kapakun e enës së detergjentit apo duke mbyllur paketimin e detergjentit.

1.3 Siguria ndaj rrymës elektrike

- ▶ Nëse produkti ka një defekt, nuk duhet të vihet në punë përveçse kur riparohet nga Agjenti i Autorizuar i Shërbimit. Rrezik i goditjes elektrike!
- ▶ Ky produkt është projektuar në mënyrë të tillë që të rifillojë punën pas një shkëputjeje të energjisë në rastin kur është në prizë. Nëse dëshironi të anuloni programin, shihni pjesën "Anulimi i programit".
- ▶ Lidhni produktin me një prizë të tokëzuar të mbrojtur nga një siguresë 16 A. Mos e neglizhoni marrjen e një specialisti elektrik të kualifikuar për të bërë instalimin e tokëzuar. Kompania jonë nuk do të mbajë përgjegjësi për ndonjë dëmtim që mund të kryhet kur produkti përdoret pa tokëzim në përputhje me rregulloret lokale.
- ▶ Mos e lani produktin duke spërkatur ose derdhur ujë mbi të. Rrezik i goditjes elektrike!
- ▶ Mos e prekni asnjëherë spinën e korrentit me duar të lagura! Mos e kapni kabllin e korrentit për ta hequr makinerinë nga priza, gjithmonë shkëputeni duke mbajtur prizën me një dorë dhe duke tërhequr spinën me dorën tjetër.
- ▶ Produkti duhet të jetë i hequr nga priza gjatë procedurave të instalimit, mirëmbajtjes dhe riparimit.
- ▶ Nëse kordoni elektrik është i dëmtuar, duhet të zëvendësohet nga prodhuesi, pas shërbimit të shitjes apo një person i ngjashëm i kualifikuar (mundësisht një specialist i energjisë) apo dikush i caktuar nga importuesi me qëllim shmangien e rreziqeve të mundshme.

1.4 Siguria ndaj sipërfaqeve të nxehta

	Gjatë larjes të rrobave në temperatura të larta, dera e ngarkimit prej qelqi do të nxehet. Duke marrë parasysh këtë fakt, gjatë punës të larjes mbajini fëmijët larg nga dera e ngarkimit të produktit për të mos i lejuar ta prekin.
---	--

2 Udhëzime të rëndësishme për mbrojtjen e mjedisit

2.1 Përputhshmëria me direktivën WEEE



Ky produkt përputhet me direktivën EU WEEE (2012/19/EU). Ky produkt mban një simbol të klasifikimit për mbeturinat e pajisjeve elektrike dhe elektronike (WEEE).

Ky produkt është prodhuar me pjesë dhe materiale me cilësi të lartë të cilat mund të ripërdoren dhe janë të përshtatshme për riciklim. Mos e hidhni produktin me mbeturinat shtëpiake normale në fund të jetës së tij të shërbimit. Çojeni atë në një qendër grumbullimi të riciklimit të pajisjeve elektrike dhe elektronike. Ju lutemi këshillohuni me autoritetet lokale për të mësuar për këto qendrat më të afërt të grumbullimit.

Përputhshmëria me direktivën RoHS:

Produkti ju keni blerë përputhet me direktivën EU RoHS (2011/65/EU). Ajo nuk përmban materiale të dëmshme dhe të ndaluara të përcaktuara në Direktivën.

2.2 Informacion për paketimin

Materialet paketuuese të këtij produkti janë prodhuar nga materiale të riciklueshme në përputhje me Rregulloren tonë Kombëtare të Mjedisit. Mos i hidhni materialet paketuuese bashkë me mbeturinat shtëpiake apo të tjera. Çojini ato në pikat e grumbullimit të materialeve paketuuese të parashikuara nga autoritetet lokale.

3 Përdorimi i synuar

- Ky produkt është projektuar për përdorim shtëpiak. Nuk është për qëllime tregtare dhe as nuk duhet të përdoret jashtë përdorimit të synuar.
- Produkti duhet të përdoret vetëm për larjen dhe shpëlarjen e rrobave në përputhje me përcaktimet.
- Prodhuesi nuk mban asnjë përgjegjësi që rrjedh nga përdorimi apo transportimi jo i duhur.
- Jetëgjatësia e shërbimit të produktit tuaj është 10 vite. Gjatë kësaj periudhe, pjesët origjinale të këmbimit do të jenë në dispozicion për ta përdorur pajisjen mirë.

Pajtimi me Rregulloren e Komisionit të Deleguar (BE) Nr 1061/2010	
Emri i furnitorit ose marka e tregtisë	Beko
Emri i modelit	WMY 71233 LMB3
Kapaciteti nominal (kg)	7
Klasa e energjisë / Shkalla nga A+++ (Efikasiteti më i lartë) deri në D Efikasiteti më i ulët)	A+++
Konsumi vjetor i energjisë (kilovat-orë) ⁽¹⁾	171
Konsumi i energjisë së programit standard 60°C të pambukut me ngarkesë të plotë (kWh)	0.950
Konsumi i energjisë së programit standard 60°C të pambukut me ngarkesë të pjesshme (kWh)	0.620
Konsumi i energjisë së programit standard 40° të pambukut me ngarkesë të pjesshme (kWh)	0.600
Konsumi i energjisë në “modalitet të fukur” (W)	0.250
Konsumi i energjisë në “modalitet të lënë ndezur” (W)	1.000
Konsumi vjetor i ujit (l) ⁽²⁾	10560
Klasa e efikasitetit të tharjes me centrifugim / Shkalla nga A (Efikasiteti më i lartë) deri në G Efikasiteti më i ulët)	B
Shpejtësia maksimale e centrifugimit (rpm)	1200
Përmbajtja e lagështisë së mbetur (%)	53
Programi standard i pambukut ⁽³⁾	Ekologjike për pambukun në 60°C dhe 40°C
Koha e programimit të programit standard 60°C të pambukut me ngarkesë të plotë (min)	211
Koha e programimit të programit standard 60°C të pambukut me ngarkesë të pjesshme (min)	185
Koha e programimit të programit standard 40° të pambukut me ngarkesë të pjesshme (min)	187
Kohëzgjatja e modalitetit të lënë ndezur (min)	N/A
Emetimet e zhurmës akustike gjatë larjes/centrifugimit (dB)	62/77
E brendshme	Non
Lartësi (cm)	84
Gjerësi (cm)	60
Thellësi (cm)	50
Peshë neto (±4 kg)	66
Me një grykë uji / Me dy gryka uji	• / -
• Në dispozicion	
Elektriciteti (V/Hz)	230 V / 50Hz
Rrymë elektrike totale (A)	10
Forca totale (W)	2200
Shifër për modeli kryesore	9210
⁽¹⁾ Konsumi i energjisë së bazuar në 220 cikle standarde larjeje për programet e pambukut në 60°C dhe 40°C me ngarkesë të plotë dhe të pjesshme dhe konsumi i modaliteteve me fuqi të ulët. Konsumi aktual i energjisë varet nga mënyra si përdoret pajisja.	
⁽²⁾ Konsumi i ujit i bazuar në 220 ciklet standarde të larjes për programet e pambukut në 60°C dhe 40°C me ngarkesë të plotë dhe të pjesshme. Konsumi aktual i ujit varet nga mënyra si përdoret pajisja.	
⁽³⁾ „Programi standard 60°C i pambukut” dhe „programi standard 40°C i pambukut” janë programet standarde të larjes me të cilat lidhet informacioni në etiketë dhe këto programe janë të përshtatshme për të pastruar rrobat me ndotje normale dhe se janë programet më efikase për sa i përket konsumit të energjisë dhe ujit.	
Specifikimet teknike mund të ndryshohen pa paralajmërim për të përmirësuar cilësinë e produktit.	

4.1 Instalimi

- Kërkojini agjentit më të afërt të autorizuar të shërbimit për instalimin e produktit tuaj.
- Përgatitja e vendit dhe instalimeve elektrike, të furnizimit me ujë dhe largimit të ujit të përdorur në vendin e instalimit, është nën përgjegjësinë e blerësit.
- Sigurohuni që tubat e ngakimit dhe shkarkimit të ujit dhe gjithashtu kordoni elektrik nuk janë të palosur, të shtypur ose të thërrmuar gjatë shtyrjes së produktit në vendin e tij pas procedurave të instalimit apo pastrimit.
- Sigurohuni që instalimi dhe lidhjet elektrike të produktit të bëhen nga shërbimi i autorizuar. Prodhuesi nuk do të mbajë përgjegjësi për dëmtime që mund të bëhen nga procedura të kryera nga persona të paautorizuar.
- Përpara instalimit, kontrolloni me sy nëse produkti ka ndonjë defekt të dukshëm. Nëse po, mos e instaloni. Produktet e dëmtuara shkaktojnë rreziqe për sigurinë tuaj.

4.1.1 Vendi i përshtatshëm i instalimit

- Vendoseni produktin mbi një dyshe me fortë dhe të niveluar. Mos e vendosni mbi qilim të trashë ose sipërfaqe të ngjashme.
- Kur makina larëse dhe makina tharëse vendosen mbi njëra tjetrën, pesha e tyre totale - kur është e ngarkuar - shkon në 180 kilogram. Vendoseni produktin në një sipërfaqe të sheshtë dhe të fortë që ka kapacitet mbajtës të mjaftueshëm!
- Mos e vendosni produktin mbi kordonin elektrik.
- Mos e instaloni produktin në mjedise ku temperatura bie nën 0 °C.
- Lini një hapësirë minimale prej 1 cm midis makinerisë dhe mobilieve.
- Mbi një dyshe të shkallëzuar, mos e vendosni produktin pranë cepit ose mbi një platformë.


4.1.2 Heqja e përforcimeve të paketimit



Anoni makinerinë nga ana e pasme për të hequr paketimet përforcuese. Hiqini paketimet përforcuese duke tërhequr shiritin. Mos e bëni vetëm këtë punë.

4.1.3 Heqja e kyçeve të transportit

- 1 Lironi të gjitha vidat me një çelës të përshtatshëm derisa të rrotullohen lirshëm.
- 2 Hiqini vidat e sigurisë të transportit duke i rrotulluar pak.
- 3 Vendosni kapakët plastikë në qesen ku është manuali i përdoruesit në hapësirat në panelin e pasmë.



KUJDES: Hiqini bulonat e sigurisë së transportit përpara vënies në punë të makinës larëse! Në rast të kundërt, produkti do të dëmtohet.




Ruajini bulonat e sigurisë së transportit në një vend të sigurt që ti ripërdorni kur makina larëse duhet të lëvizet sërish në të ardhmen.

Instaloni vidat e sigurisë të transportit në rend të kundërt të procedurës të çmontimit.

Mos e lëvizni asnjëherë produktin pa vendosur në vend siç duhen bulonat e sigurisë së transportit!

4.1.4 Lidhja e furnizimit me ujë

	Presioni i furnizimit me ujë që kërkohet për të vënë në punë produktin është midis 1 dhe 10 (0.1 – 1 MPa). Është e nevojshme që të keni 10 - 80 litra ujë të rrjedhshëm në një minutë nga rubineti i hapur plotësisht që makineria të punojë normalisht. Vendosni një valvul që ul presionin nëse presioni i ujit është i lartë.
	KUJDES: Modelet me një hyrje të vetme të ujit nuk duhet të lidhen me rubinetin e ujit të nxehtë. Në një rast të tillë rrobat do të dëmtohen ose produkti do të kalojë në metodën e mbrojtur dhe nuk do të punojë.
	KUJDES: Mos përdorni tuba uji hyrës të vjetër apo të përdorur për produktin e ri. Mund të krijohë njolla mbi rrobat tuaja.




- 1 Shtërngoni vidat e tubit me dorë. Mos përdorni asnjëherë mjet për të shtërnguar vidat.
- 2 Kur të jetë bërë lidhja e tubit, kontrolloni nëse ka probleme rrjedhjeje në pikat e lidhjes duke i hapur rubinetet plotësisht. Nëse ka ndonjë rrjedhje, mbyllni rubinetin dhe hiqni vidën. Shtërngoni sërish vidën me kujdes pasi të keni kontrolluar mbylljen. Për të mos lejuar rrjedhje uji dhe dëmtimet që vijnë si rezultat, mbajini rubinetet të mbyllur kur nuk e përdorni produktin.

4.1.5 Lidhja e tubacionit të kullimit

- Lidheni fundin e tubit të shkarkimit direkt me direkt me shkarkimin e ujërave, lavamanin ose vaskën.

	KUJDES: Shtëpia juaj do të përmytet nëse marçuqi del nga vendi gjatë shkarkimit të ujit. Për më tepër, ekziston rreziku i përvëlimit për shkak të temperaturave të larta të larjes. Për të mos lejuar situata të tilla dhe për t'u siguruar që makineria të kryejë pa probleme proceset e futesh dhe shkarkimit të ujit, shtërngojeni fort tubin e shkarkimit.
---	---



- Lidheni tubin e kullimit në një lartësi minimale prej 40 cm dhe një lartësi maksimale prej 100 cm.
- Në rastin kur tubi i kullimit ngrihet pasi ka qenë në nivelin e dyshemesë ose afër tokës (më pak se 40 cm mbi tokë), shkarkimi i ujit bëhet më i vështirë dhe rrobat mund të dalin shumë të njoma. Prandaj, merrni parasysh lartësitë e treguara në figurë.

- Për të mos lejuar ujin e përdorur të kthehet përsëri në makineri dhe për të siguruar shkarkim të lehtë, mos e zhytni fundin e tubit në ujin e shkarkuar ose mos e futni në shkarkim më thellë se 15 cm. Nëse është shumë i gjatë, priteni.
- Fundi i tubit nuk duhet të jetë i palosur, nuk duhet të jetë i shtypur dhe tubi nuk duhet të jetë i bllokuar midis shkarkuesit dhe makinerisë.
- Nëse gjatësia e tubit është e pamjaftueshme, përdoreni duke i shtuar një tub shtesë original. Gjatësia e tubit nuk mund të jetë më e gjatë se 3.2 m. Për të shmangur problemet me rrjedhjen e ujit, lidhja midis tubit të shtuar dhe tubit të shkarkimit duhet të mbërthehet mirë me një morsetë të përshtatshme që të mos rrjedhë.

4.1.6 Rregullimi i shputave



KUJDES: Me qëllim që të sigurohemi që produkti punon pa zhurma dhe pa dridhje, ai duhet të qëndrojë në nivel dhe i balancuar me këmbët e tij. Balanconi makinerinë duke rregulluar këmbët. Përndryshe, produkti mund të lëvizë nga vendi i tij dhe të shkaktojë shtypje dhe probleme me dridhjen.

KUJDES: Mos përdorni asnjë mjet për të liruar vidat bllokuese. Në të kundërt, ato do të dëmtohen.

- 1 Lironi me dorë vidat bllokuese të këmbëve.
- 2 Rregulloni këmbët derisa produkti të qëndrojë në një mënyrë të qëndrueshme dhe të balancuar.
3. Shtrëngoni përsëri me dorë të gjitha vidat e bllokimit.



4.1.7 Lidhja elektrike

Lidheni produktin me një prizë të tokëzuar të mbrojtur nga një siguresë 16 A. Kompania jonë nuk do të mbajë përgjegjësi për ndonjë dëmtim që mund të kryhet kur produkti përdoret pa tokëzim në përputhje me rregulloret lokale.

- Lidhja duhet të jetë në përputhje me rregulloret kombëtare.
- Spina e kordonit elektrik duhet të arrihet lehtësisht pas instalimit.
- Nëse vlera aktuale e siguresës apo çelësit në shtëpi është më pak se 16 Amps, merrni një specialist elektrik të kualifikuar për të instaluar një siguresë 16 Amp.
- Voltazhi i përcaktuar në pjesën "Specifikimet teknike" duhet të jetë i barabartë me voltazhin e energjisë tuaj.
- Mos bëni lidhje nëpërmjet kordonëve zgjatues apo me shumë priza.



KUJDES: Kordonët elektrikë të dëmtuar duhet të zëvendësohen nga Agjentët e Autorizuar të Shërbimit.

4.1.8 Përdorimi fillestar



Para se të filloni ta përdorni produktin sigurohuni që të jenë bërë përgatitjet të cilat janë në përputhje me "Udhëzimet e Rëndësishme të Sigurisë dhe Mjedisit" dhe udhëzimet në pjesën "Instalimi". Për ta bërë gati produktin për të larë rroba, kryeni si punë të parë programin Pastrim Kazani. Nëse ky program nuk është i disponueshëm në makinerinë tuaj, përdorni metodën që përshkruhet në pjesën 4.4.2.



Përdorni një kundër-gëlqeror të përshtatshëm për makinat larëse.

Një sasi uji mund të ketë mbetur në produkt për shkak të proceseve të kontrollit të cilësisë në prodhim. Kjo nuk është e dëmshme për produktin.

4.2 Përgatitja

4.2.1 Klasifikimi i rrobave për larje

- * Klasifikojini rrobat sipas llojit të materialit, ngjyrës dhe shkallës së ndotjes dhe temperaturës së lejuar të ujit.
- * Ndiqni gjithmonë udhëzimet që jepen në etiketat e veshjeve.

4.2.2 Përgatitja e rrobave për larje

- Rrobat që kanë pjesë të tilla si të brendshme me pjesë metalike, tokëza të rripave apo kopsa metalike do ta dëmtojnë makinerinë. Hiqini pjesët metalike ose lajini rrobat duke i vendosur ato në një çantë për larje apo këllëf.
- Hiqini të gjitha substancat në xhepa të tilla si monedhat, stilolapsat dhe kapëset metalike të letrave, dhe kthejini xhepat së prapthi dhe pastrojini. Objekte të tilla mund ta dëmtojnë produktin ose të shkakojnë probleme me zhurmën.
- Vendosini rrobat me përmasa të vogla të tilla si çorapet e bebeve dhe çorapet e najlonit në një çantë për larje ose këllëf.
- Vendosini perdet brenda pa i shtypur. Hiqini pajisjet mbajtëse të perdeve.
- Mbërthejini zinxhirët, mbyllini kopsat e hapura dhe rregulloni të grisurat dhe të çarat.
- Lajini produktet me etiketat "lahet me makineri" ose "lahet me dorë" vetëm me një program të përshtatshëm.
- Mos i lani rrobat me ngjyrë dhe ato të bardha bashkë. Veshjet e reja, të errëta të pambukta lëshojnë shumë bojë. Lajini këto rroba më vete.
- Njollat e forta duhet të trajtohen siç duhet para larjes. Nëse jeni të pasigurt, verifikojeni me një pastrim kimik.
- Përdorni vetëm bojëra / ndryshues ngjyre dhe agentë të pastrimit të kripërave të cilat janë të përshtatshme për makina larëse. Ndiqni gjithmonë udhëzimet mbi paketim.
- Lajini pantallonat dhe rrobat delikate të kthyer së prapthi.
- Ruajini artikujt e përbërë prej leshi angore në ngrirës për disa orë përpara larjes. Kjo do të ulë rënien e qimeve.
- Rrobat të cilat kanë sasi të madhe materialesh të tilla si miell, pluhur gëlqereje, qumësht pluhur etj. duhet të shkundur mirë përpara se të vendosen në makineri. Papastërti dhe pluhura të tillë në rroba mund të grumbullohen në pjesët e brendshme të makinerisë dhe mund të shkaktojnë dëmtime me kalimin e kohës.

4.2.3 Gjëra që duhen bërë për të kursyer energjinë

Informacioni në vijim do t'ju ndihmojë që ta përdorni produktin në një mënyrë ekologjike dhe eficiente në lidhje me energjinë.

- Përdorni produktin me kapacitetin më të lartë të lejuar nga programi që keni përzgjedhur por mos e mbingarkoni; shihni "Tabela e programeve dhe konsumit". Shihni "Tabela e programeve dhe konsumit"
- Ndiqni gjithmonë udhëzimet në paketimin e detergjentit.
- Lajini rrobat pak të ndotura me temperatura të ulëta.
- Përdorni programe më të shpejta për sasi të vogla rrobash pak të ndotura.
- Mos përdorni paralarjen dhe temperatura të larta për rroba që nuk janë shumë të ndotura apo me njolla.
- Nëse keni ndërmend t'i thani rrobat në makinë tharëse, zgjidhni shpejtësinë më të lartë të centrifugës të rekomanduar gjatë procesit të larjes.
- Mos përdorni më shumë detergjent se sasia e rekomanduar e treguar në paketimin e tij.

4.2.4 Futja e rrobave për larje

1. Hapni kapakun e rrobave.
2. Vendosini rrobat në makineri në mënyrë të lirshme.
3. Shtyjeni dhe mbylleni kapakun e ngarkimit derisa të dëgjoni një zhurmë bllokimi. Sigurohuni që të mos kenë mbetur rroba të kapura te dera. Dera e ngarkimit kyçet ndërsa një program është në punë. Dera mund të hapet pak pasi programi të përfundojë.

4.2.5 Kapaciteti i duhur

Kapaciteti maksimal i ngarkesës varet nga lloji i rrobave, niveli i ndojes dhe programi i larjes që dëshironi. Makinaria rregullon automatikisht sasinë e ujit sipas peshës të rrobave të futura në të.




PARALAJMËRIM: Ndiqni informacionin në "Tabelën e programit dhe konsumit". Në rast se mbingarkohet, performanca e larjes së makinerisë do të ulet. Për më tepër, mund të ketë probleme me zhurmën dhe dridhjet.

4.2.6 Përdorni i detergjentit dhe zbutësit



Kur përdorni detergjent, zbutës, sodë, bojë cope, zbardhues dhe dekolorant, agjentë kripërash; lexoni udhëzimet e prodhuesit të shkruara mbi paketim dhe ndiqni dozat e përcaktuara. Përdorni gotën e masës nëse ka.



Sirtari i detergjentit përbëhet nga tre ndarje:

- (1) për paralarjen
- (2) për larjen kryesore
- (3) për zbutjen
- (☼) në vazhdim, për më tepër ka një pjesë sifoni në ndarësen e zbutësit.

Detergjenti, zbutësi dhe agjentët e tjerë të pastrimit

- Shtoni detergjent dhe zbutës përpara nisjes së programit të larjes.
 - Ndërkohë që cikli i larjes është në progres, mos e lini dispenserin e detergjentit të hapur!
 - Kur përdorni një program pa paralarje, mos vendosni detergjent në ndarësen e paralarjes (ndarësja nr. "1").
 - Në një program me paralarje, mos vendosni detergjent të lëngshëm në ndarësen e paralarjes (ndarësja nr. "1").
 - Mos përgjigdhni një program me paralarje nëse do të përdorni një detergjent të paketuar ose tabletë të tretshme. Vendosni detergjentin e paketuar ose tabletën e tretshme direkt midis rrobave në makineri.
- Nëse do të përdorni një detergjent të lëngshëm, mos harroni të vendosni mbajtësin e detergjentit të lëngshëm në ndarësen e larjes kryesore (ndarësja numër "2").

Zgjedhja e llojit të detergjentit

Lloji i detergjentit që do të përdoret varet nga lloji dhe ngjyra e copës.

- Përdorni detergjentë të ndryshëm për rrobat me ngjyra dhe të bardha.
- Lajini rrobat tuaja delikate vetëm me detergjentë të veçantë (detergjentë të lëngshëm, shampo për të leshtat, etj.) që përdoren vetëm për rroba delikate.
- Kur lani rroba me ngjyra të errëta apo jorganë, rekomandohet që të përdoret detergjent i lëngshëm.
- Lajini të leshtat me detergjentë të veçantë të prodhuar në mënyrë specifike për të leshtat.



KUJDES: Përdorni vetëm detergjente të prodhuar në mënyrë specifike për makina larëse automatike.

KUJDES: Mos përdorni pluhur sapuni.

Rregullimi i sasisë së detergjentit

Sasia e detergjentit larës që duhet të përdoret varet nga sasia e rrobave, niveli i ndotjes dhe fortësia e ujit.

- Mos përdorni sasi që i tejkalojnë dozat e rekomanduara në paketimin e detergjentit për të shmangur problemet e shumës së tepërt, shpërlarjes jo të mirë, kursimeve financiare dhe në fund, mbrojtjes së mjedisit.
- Përdorni më pak detergjent për sasi të vogla të rrobave pak të ndotura.


Përdorimi i zbutësve

Hidheni zbutësin në ndarësen e zbutësit të sirtarit të detergjentit.

- Mos e kaloni shenjën e nivelit (>max<) në ndarjen e zbutësit.
- Nëse zbutësi e ka humbur rrjedhshmërinë, hollojeni me ujë përpara se ta vendosni në sirtarin e detergjentit.

Përdorimi i detergjenteve të lëngshme.

Nëse produkti ka një gotë për detergent të lëngshëm.



- Hidheni mbajtësin e detergentit të lëngshëm në ndarjen nr "2".
- Nëse detergjenti i lëngshëm e ka humbur fluiditetin, hollojeni me ujë para se ta vendosni në mbajtësin e detergentit.

Nëse produkti nuk ka një gotë për detergent të lëngshëm.

- Mos përdorni detergjente të lëngshme për paralarjen në një program me paralarje.
- Detergjenti i lëngshëm i njoslos rrobat kur përdoret me funksionin e Nisjes të Vonuar. Nëse do të përdorni funksionin e Nisjes të Vonuar, mos përdorni detergent të lëngshëm.

Përdorimi i detergjentit xhel dhe tablet.

- Nëse trashësia e detergjentit xhel është e lëngshme dhe makineria juaj nuk ka një gotë të veçantë për detergjentin e lëngshëm, hidheni detergjentin xhel në ndarjen e detergjentit të larjes gjatë marrjes të parë të ujit. Nëse makineria juaj ka një gotë detergjenti të lëngshëm, hidheni detergjentin në këtë gotë para se të nisni programin.
- Nëse trashësia e detergjentit xhel nuk është e lëngshme ose është në formën e kapsulës të lëngshme, futeni direkt në kazan para larjes.
- Hidhni detergjentet tablet në ndarjen kryesore të larjes (ndarja nr. "2") ose direkt në kazan para larjes.

Përdorimi i sodës të rrobave

- Vendoseni sodën e lëngshme, sodën pluhur ose bojën e copës në ndarjen e zbutësit.

Mos përdorni zbutës dhe sodë rrobash së bashku në një cikël larjeje.

Fshijeni pjesën e brendshme të makinerisë me një leckë të njomë dhe të pastër pasi të keni përdorur sodë rrobash.

Përdorimi i kundër-gëlqerorit

- Kur nevojitet, përdorni kundër-gëlqerorët e prodhuar në mënyrë specifike vetëm për makinat larëse.

Përdorimi i zbardhuesve

Shtoni zbardhues në fillim të ciklit të larjes duke zgjedhur një program paralarjeje. Mos vendosni detergent në ndarësen e paralarjes. Si aplikim alternativ, zgjidhni një program me shpëlarje ekstra dhe shtoni agjent zbardhues ndërsa makineria merr ujë nga ndarja e detergjentit gjatë hapit të shpëlarjes.


- Mos përdorni agjent zbardhues dhe detergent duke i përzier ata.
- Përdorni një sasi të vogël (afërsisht 50 ml) të agjentit zbardhues dhe shpëlajini rrobat mirë sepse shkakton acarim të lëkurës. Mos hidhni zbardhues në rroba dhe mos e përdorni me rroba me ngjyra.
- Kur përdorni dekolozant me bazë oksigjeni, zgjidhni një program i cili i lan rrobat në temperaturë të ulët.
- Dekoloranti me bazë oksigjeni mund të përdoret me detergent; sidoqoftë, nëse nuk është me të njëjtën konsistencë, më parë hidhni detergjentin në ndarjen numër "2" në dispenser dhe prisni që makineria ta marrë detergjentin kur merr ujin. Kur makineria vazhdon marrjen e ujit, shtoni dekolozant në të njëjtën ndarje.

4.2.7 Këshilla për larje efikase

		Rrobat			
		Ngjyra të lehta dhe të bardha	Me ngjyra	Ngyra të zeza/errëta	Delikate/Të leshta/Të mëndafshhta
		(Shkalla e temperaturës së rekomanduar në bazë të nivelit të ndotjes. 40-90 oC)	(Intervali i rekomanduar i temperaturës në bazë të nivelit të njollave: ftohtë -40 oC)	(Intervali i rekomanduar i temperaturës në bazë të nivelit të njollave: ftohtë -40 oC)	(Shkalla e temperaturës së rekomanduar në bazë të nivelit të ndotjes. e ftohtë -30 oC)
Niveli i Ndotjes	Shumë të Ndotura (njolla të vështira të tilla si bari, kafeja, frutat dhe gjaku.)	Mund të jetë e nevojshme që njollat të para-trajtohen ose të kryhet paralarja. Detergjentët pluhur dhe të lëngshëm të rekomanduar për rrobat e bardha mund të përdoren në dozat e rekomanduara për rrobat shumë të ndotura. Rekomandohet që të përdoren detergjentë pluhur për të pastruar njollat e baltës dhe dheut dhe njollat që janë të ndjeshme ndaj zbardhuesve.	Detergjentët pluhur dhe të lëngshëm të rekomanduar për rrobat me ngjyra mund të përdoren në dozat e rekomanduara për rrobat shumë të ndotura. Rekomandohet që të përdoren detergjentë pluhur për të pastruar njollat e baltës dhe dheut dhe njollat që janë të ndjeshme ndaj zbardhuesve. Përdorini detergjentët pa zbardhje.	Detergjentët e lëngshëm të përshtatshëm për rrobat me ngjyra dhe të errëta mund të përdoren në dozat e rekomanduara për rrobat shumë të ndotura.	Parapëlqeni detergjentët e lëngshëm të prodhuar për rrobat delikate. Rrobat e leshta dhe të mëndafshhta duhet të lahen me detergjentë të veçantë për të leshtat.
	Të Ndotura Normalisht (Për shembull, njolla të shkaktuara nga trupi në jaka dhe mëngë)	Detergjentët pluhur dhe të lëngshëm të rekomanduar për rrobat me ngjyra mund të përdoren në dozat e rekomanduara për rrobat e ndotura normalisht.	Detergjentët pluhur dhe të lëngshëm të rekomanduar për rrobat me ngjyra mund të përdoren në dozat e rekomanduara për rrobat e ndotura normalisht. Detergjentët që nuk përmbajnë zbardhues nuk duhet të përdoren.	Detergjentët e lëngshëm të përshtatshëm për rrobat me ngjyra dhe të errëta mund të përdoren në dozat e rekomanduara për rrobat e ndotura normalisht.	Parapëlqeni detergjentët e lëngshëm të prodhuar për rrobat delikate. Rrobat e leshta dhe të mëndafshhta duhet të lahen me detergjentë të veçantë për të leshtat.
	Pak të Ndotura (Nuk ka njolla të dukshme.)	Detergjentët pluhur dhe të lëngshëm të rekomanduar për rrobat me ngjyra mund të përdoren në dozat e rekomanduara për rrobat pak të ndotura.	Detergjentët e lëngshëm të përshtatshëm për rrobat me ngjyra dhe të errëta mund të përdoren në dozat e rekomanduara për rrobat pak të ndotura. Detergjentët që nuk përmbajnë zbardhues nuk duhet të përdoren.	Detergjentët e lëngshëm të përshtatshëm për rrobat me ngjyra dhe të errëta mund të përdoren në dozat e rekomanduara për rrobat pak të ndotura.	Parapëlqeni detergjentët e lëngshëm të prodhuar për rrobat delikate. Rrobat e leshta dhe të mëndafshhta duhet të lahen me detergjentë të veçantë për të leshtat.

4.3 Përdorimi i produktut

4.3.1 Paneli i kontrollit



- 1 - Çelësi i Përzgjedhjes së programit (Pozicioni më i sipërm Ndezur/Fikur)
- 2 - Ekran
- 3 - Butoni i nisjes të vonuar
- 4 - Treguesi i Ndjekjes së programit
- 5 - Butoni Nisje / Pushim
- 6 - Butonat e Funksioneve ndihmëse
- 7 - Butoni i rregullimit të Shpejtësisë së Centrifugimit
- 8 - Butoni i Rregullimit të temperaturës

Vlerat treguese për programet Sintetike (SQ)						
	Ngarkesa (kg)	Konsumi i Ujit (l)	Konsumi i Energjisë (kilovat-orë)	Kohëzgjatja e programit (min) *	Përmbytja e lagështisë së mbetur (%) **	Përmbytja e lagështisë së mbetur (%) **
					≤ 1000 rpm	> 1000 rpm
Sintetike 60	3	50	0.95	100/120	45	40
Sintetike 40	3	50	0.73	90/110	45	40

* Ju mund të shihni kohën e larjes së programit që keni përzgjedhur në ekranin e makinerisë. Është normale që të ketë diferenca të vogla midis kohës që tregohet në ekran dhe kohës reale të larjes.

** Vlerat e përmbytjes të lagështisë së mbetur mund të ndryshojnë sipas shpejtësisë të zgjedhur të centrifugës.

Pambuk Eco

Të pambukta

Sintetike

Të lehta

Larje me dorë

MbrojtjeBebësh

Larja e robave të errëta (Kujdes për roba të errëta)

Larja e robave të errëta (Kujdes për roba të errëta)

Jorgan (Çarçafë e mbulesa)

Tharje (Pompim)

Shpëlarje

Freskuar

Shpëlarje shitesë (Shpëlarje plus)

Larje e shpejt

Shtyrje e kohës

Paralarje

Regjimi i natës

Të përziera 40

Ekspres ditor

Ekspres super i shkurtër

Centrifugë

Delicati 20°

40° 40'

hygiene 20°

Program Automatik

Këmisha (Shirts)

Mbrojtja gjatë procesit përfundimtar

Avull

Larje

MbrojtjeBesh+

Heqja e Qimeve të Kafshëve

4.3.2 Zgjedhja e programit

- 1 Përcaktoni programin e përshtatshëm për llojin, sasinë dhe nivelin e njollave të rrobave në përputhje me tabelën "Tabela e programeve dhe konsumit".
- 1 Përzgjidhni programin e dëshiruar nëpërmjet çelësit të "Përzgjedhjes së Programit".

	Programet janë të kufizuar me shpejtësinë më të madhe të rotullimit të përshtatshme për ato lloj të veçantë të pëlhurës.
	Kur zgjidhni programin që do të përdorni, merrni gjithmonë parasysh llojin e copës, ngjyrën, shkallën e njollave dhe temperaturën e lejuar të ujit.
	Preferoni gjithmonë vlerën më të ulët të temperaturës e cila përshtatet me llojin e rrobave tuaja. Temperaturë më e lartë do të thotë konsum më i lartë i energjisë elektrike.

4.3.3 Programet

• Pambuk

Përdoreni për rrobat tuaja prej pambuku (të tilla si çarçafë, komplete këllëfësh dhe me pupla, peshqirë, peshqirë banjo, të brendshme, etj.). Rrobat tuaja do të lahen me veprim të fuqishëm larjeje për një cikël larjeje më të gjatë.

• Sintetike

Përdoreni për të larë rrobat tuaja sintetike (këmisha, bluza, sintetike/pambuk të përziera, etj.). Ai lan me një veprim më të butë dhe ka një cikël larje më të shkurtër krahasuar me programin për të Pambukët. Për perde dhe tyl, përdorni programin për sintetiket 40°C me funksionin e paralarjes dhe kundër rrudhave të përzgjedhur. Meqë struktura e tyre në formë rrjete shkakton shumë shkurrim, lani velot/tylet duke vendosur një sasi të vogël detergjenti në ndarësen kryesore të larjes. Mos vendosni detergjent në ndarësen e paralarjes.

• Lesh

Përdoreni për të larë rrobat tuaja të leshta. Përzgjidhni temperaturën e përshtatshme në përputhje me etiketat e veshjeve tuaja. Përdorni detergjente të përshtatshme për të leshtat.

 APPAREL CARE	"Cikli i larjes së të leshtave e kësaj makinerie është aprovuar nga The Woolmark Company për larjen e produkteve të leshta që mund të lahen në makinë larëse me kusht që produktet të lahen sipas udhëzimeve në etiketën e rrobave dhe sipas atyre të dhëna nga prodhuesi i kësaj makine larëse. M1424."
	"Në Mbretërinë e Bashkuar, Irlandë, Hong Kong dhe Indi marka tregtare Woolmark është një markë Certifikimi."

• Pambuk Ekonomik

Përdoreni për të larë rrobat prej pambuku dhe mëndafshi të forta dhe me njolla normale. Megjithatë lan më gjatë se të gjitha programet e tjera, ajo siguron kursime të larta të energjisë dhe ujit. Temperatura aktuale e ujit mund të jetë e ndryshëm nga temperatura e treguar e larjes. Kur e ngarkoni makinerinë me më pak rroba (p.sh. ½ e kapacitetit ose më pak), programi mund të shkurtohet automatikisht. Në këtë rast, konsumi i energjisë dhe ujit do të ulet akoma më shumë, duke siguruar një larje më ekonomike. Ky program është i disponueshëm për modelet me treguesin e kohës të mbetur.

• BabyProtect (Mbrotjen e fëmijës)

Përdoreni këtë program për rrobat tuaja për të cilat doni një larje anti-alergjike dhe higjienike në temperaturë të lartë me cikël intensiv dhe me larje të gjatë.

• Delikate 20°

Përdoreni për të larë rrobat tuaja delikate. Ai lan me një veprim të butë pa ndonjë centrifugim të brendshëm krahasuar me programin për Sintetiket. Duhet të përdoret për rrobat për të cilat rekomandohet larja delikate.

• Larje me dorë

Përdoreni për të larë rrobat tuaja të leshta/delikate që kanë etiketa "të mos lahet me makinë" dhe për të cilat rekomandohet larja me dorë. Ai i lan rrobat me një veprim larje shumë të butë që të mos i dëmtojë ato.

• Mini

Përdorni këtë program për të larë sasinë e vogël të veshjeve tuaja prej pambuku pak të ndotura për një kohë të shkurtër.

• Ekspres super i shkurtër

Përdoreni për të larë rrobat e pambukta me pak njolla ose pa njolla në një kohë të shkurtër.

• Larja e rrobave të errët

Përdoreni këtë program për të larë rrobat e errëta ose me ngjyra të cilat nuk doni që të zbehen. Larja kryhet me më pak lëvizje mekanike në temperaturë të ulët. Rekomandohet që të përdoret detergjent i lëngshëm ose shampo për të leshtat për rrobat me ngjyrë të errët.

- **Të përziera 40 (Mix 40)**

Përdorni këtë program për të larë rrobat tuaja prej pambuku dhe sintetike së bashku pa i ndarë.

- **Këmisha**

Përdorni për të larë këmishat prej pambuku, sintetike dhe pëlhurat e përziera sintetike së bashku.

- **Hygiene 20°**

Përdorni këtë program për rrobat tuaja të cilat ju duhet larje me temperaturë më të ulët me cikël larjeje intensiv dhe të gjatë. Përdorni këtë program për rrobat tuaja të cilat kërkojnë larje higjienike në temperaturë më të ulët.

- **Shpëlarja**

Përdorni kur doni të shpëlani ose zbardhni veç.

- **Centrifuga + Shkarkimi**

Përdorni për të shkarkuar ujin në makineri.

4.3.4 Zgjedhja e temperaturës

Kur përzgjidhet një program i ri, temperatura e rekomanduar për programin e përzgjedhur shfaqet në treguesin e temperaturës.

Për të ulur temperaturën, shtypni butonin e Rregullimit të Temperaturës. Temperatura do të ulet ngadalë.



Nëse programi nuk e ka arritur fazën e nxehjes, mund ta ndryshoni temperaturën pa e kaluar makinerinë në mënyrën e Pushimit.

4.3.5 Përzgjedhja e shpejtësisë së centrifugimit

Kur përzgjidhet një program i ri, shpejtësia e rrotullimit që rekomandohet për programin e përzgjedhur shfaqet në treguesin e shpejtësisë së rrotullimit.

Për të ulur shpejtësinë e rrotullimit, shtypni butonin e Rregullimit të Shpejtësisë së Rrotullimit. Shpejtësia e centrifugimit bie ngadalë.

Pastaj, në varësi të modelit të produktit, opsionet "Mbaj në Shpëlarje" dhe "Pa rrotullim" shfaqen në ekran. Shihni pjesën "Përzgjedhja e funksioneve ndihmëse" për shpjegime të këtyre opsioneve.



Nëse programi nuk e ka arritur fazën e rrotullimit, mund ta ndryshoni shpejtësinë pa e kaluar makinerinë në mënyrën e Pushimit.

Mbajtja në Shpëlarje

Nëse nuk do ti zbrazni rrobat menjëherë pasi programi të përfundojë, mund të përdorni funksionin e mbajtjes në shpëlarje për ti mbajtur rrobat tuaja në ujin e shpëlarjes së fundit me qëllim që të parandalojë që ato të zhubrosen kur në makineri nuk ka ujë. Shtypni butonin Nisje / Pushim pas këtij procesi nëse doni të thani ujin pa rrotulluar rrobat tuaja. Programi do të rifillojë dhe do të përfundojë pas shkarkimit të ujit.

Nëse doni të rrotulloni rrobat që gjenden në ujë, rregulloni Shpejtësinë e Rrotullimit dhe shtypni butonin Nisje / Pushim.

Programi rifillon. Uji thahet, rrobat rrotullohen dhe programi përfundon.

4.3.6 Tabela e programit dhe konsumit

SQ					Funksione Ndhëmëse				
Programi		Ngarkesa Maksimale (kg)	Konsumi i Ujit (l)	Konsumi i Energjisë (kilovat-orë)	Shpejtësia maks.***	Paralarje	Larje e Shpejtë	Shpëlarja Plus	Shtrirja e temperaturës të zgjedhur °C
Pambuk Ekonomik	60**	7	53	0.95	1200				40-60
	60**	3.5	43	0.62	1200				40-60
	40**	3.5	43	0.60	1200				40-60
Pambuk	90	7	69	2.15	1200	•	•	•	Ftohtë-90
	60	7	66	1.40	1200	•	•	•	Ftohtë-90
	40	7	66	0.70	1200	•	•	•	Ftohtë-90
Sintetike	60	3	50	0.95	800	•	•	•	Ftohtë-60
	40	3	50	0.73	800	•	•	•	Ftohtë-60
Mini	90	7	55	1.80	1200			•	Ftohtë-90
	60	7	55	1.10	1200			•	Ftohtë-90
	30	7	55	0.25	1200			•	Ftohtë-90
Ekspres super i shkurtër	30	2	50	0.11	1200			•	Ftohtë-30
Këmisha	60	3	48	0.34	600	•	•	•	Ftohtë-60
Të përziera 40 (Mix 40)	40	3	50	0.73	800	•	•	•	Ftohtë-40
Larje me dorë	20	1	41	0.15	600				20
Lesh	40	1.5	56	0.27	600			•	Ftohtë-40
BabyProtect (Mbrojtjen e fëmijës)	90	7	90	2.40	1200	•		*	30-90
Larja e rrobave të errët	40	3	70	0.50	800			*	Ftohtë-40
Hygiene 20°	20	2	95	0.40	1200			*	20
Delikate 20°	20	3	45	0.15	600			•	20

- : I Përzgjedhshëm.
- * : Përzgjedhur në mënyrë automatike, nuk mund të anulohet.
- ** : Program me Etiketë Energjie (EN 60456 Ed. 3)
- *** : Nëse shpejtësia maksimale e centrifugimit të makinerisë është më poshtë se kjo vlerë, mund të përzgjidhni vetëm deri në shpejtësinë maksimale të centrifugimit.
- **** : Programi do të zbulojë llojin dhe sasinë e rrobave që keni vendosur në makinën larëse dhe do të rregullojë automatikisht konsumin e ujit, energjisë dhe kohëzgjatjen e programit.
- : Shikoni përshkrimin e programit për ngarkesën maksimale.

** "Pambuk eko 40°C dhe Pambuk eko 60°C janë programe standarde." Këto programe njihen si 'program standard pambuku 40°C' dhe 'program standard pambuku 60°C' dhe tregohen në panel me simbolet .

Funksionet ndihmëse në tabelë mund të variojnë sipas modelit të makinerisë tuaj.

Konsumi i ujit dhe energjisë mund të variojë si pasojë e ndryshimeve në presionin e ujit, fortësisë së ujit dhe temperaturës, temperaturës së mjedisit, llojit dhe sasisë së rrobave, përzgjedhjes së funksioneve ndihmëse dhe shpejtësisë së centrifugimit, dhe ndryshimeve në tensionin elektrik.

Ju mund të shihni kohën e larjes së programit që keni përzgjedhur në ekranin e makinerisë. Është normale që të ketë diferenca të vogla midis kohës që tregohet në ekran dhe kohës reale të larjes.

"Strukturat e zgjedhjes për funksionet ndihmëse mund të ndryshohen nga kompania e prodhimit. Struktura të reja zgjedhjeje mund të shtohen ose të hiqen."

"Shpejtësia e centrifugës të makinerisë tuaj mund të ndryshojë në varësi të programit; kjo shpejtësi centrifuge nuk mund ta tejkalojë shpejtësinë maks. të centrifugës të makinerisë tuaj."

"Prodhuesi ushtron të drejtën të bëjë modifikime në programet dhe funksionet ndihmëse të dhëna të tabelë. Ndërkohë që këto modifikime nuk do të ndryshojnë performancën e makinerisë, hapat e programit dhe kohëzgjatjet mund të ndryshohen."

4.3.7 Zgjedhje e funksionit plotësues

Përzgjidhni funksionet ndihmëse të nevojshme para se të nisni programin.

Kurdoherë që zgjidhet një program, nëse është zgjedhur një funksion ndihmës përkatës drita e tij treguese do të ndizet.



Dritat treguese të funksioneve ndihmëse që nuk lejohen të zgjidhen me programin aktual do të pulsojnë dhe jepet një paralajmërim audio.

Për më tepër, mund të përzgjidhni apo anuloni funksionet ndihmëse që janë të përshtatshme për programin që është në punë pasi fillon cikli i larjes. Nëse cikli i larjes ka arritur një pikë ku nuk mund të zgjidhet asnjë funksion ndihmës, do të jepet një lajmërim audio dhe drita e funksionit ndihmës përkatës do të pulsojë.



Disa funksione nuk mund të përzgjidhen së bashku. Nëse një funksion ndihmës i dytë që bie në konflikt me të parin përzgjidhet para vënies në punë të makinerisë, funksioni i përzgjedhur i pari do të anulohet dhe funksioni ndihmës i dytë do të mbetet aktiv. Për shembull, nëse doni të zgjidhni Larjen e Shpejtë pasi keni zgjedhur Ujë Shtesë, Uji Shtesë mund të anulohet dhe Larja e Shpejtë të mbetet aktive.

Nuk mund të përzgjidhet një funksion ndihmës që nuk ka përputhje me programin. (Shihni "Tabela e programeve dhe konsumit")

Disa programe kanë funksione ndihmëse që mund të përdoren njëkohësisht. Ato funksione nuk duhet të anulohen. Korniza e funksionit ndihmës nuk do të ndriçohet, vetëm pjesa e brendshme do të ndriçohet.

• Paralarje

Paralarja ia vlen të përdoret vetëm për rroba shumë të ndotura. Mospërdorimi i Paralarjes do të kursejë energji, ujë, detergjent dhe kohë.

• Larje e Shpejtë

Ky funksion mund të përdoret në programet e të Pambuktave dhe Sintetikeve. Ai ul kohët e larjes dhe gjithashtu numrin e fazave të shpërlarjes për rrobat pak të ndotura.



Kur përzgjidhni këtë funksion, mbusheni makinerinë tuaj me gjysmën e maksimumit të rrobave të përcaktuara në tabelën e programit.

• Shpërlarja Plus

Funksioni mundëson makinerinë që të bëjë një shpërlarje tjetër përveç asaj të bërë tashmë pas larjes kryesore. Prandaj, rreziku që lëkurat e ndjeshme (bebet, lëkurat alergjike, etj.) të ndikohen nga mbetjet minimale të detergjentit mbi rroba mund të pakësohet.

4.3.8 Koha e Mbarimit

Nisje e Vonuar

Me funksionin e Nisjes të Vonuar nisja e programit mund të shtyhet deri 19 orë. Koha e nisjes të vonuar mund të rritet me shkallëzime prej 1 ore.



Mos përdorni detergjentë të lëngshëm kur përzgjidhni Nisjen e Shtyrë. Ekziston rreziku i njollosjes të rrobave.

Hapeni derën e mbushjes, vendosni rrobat dhe hidhni detergjent, etj. Zgjidhni programin e larjes, temperaturën, shpejtësinë e centrifugës, nëse kërkohet, dhe funksionet ndihmëse. Vendosni kohën e dëshiruar duke shtypur butonin e Nisjes së Shtyrë. Shtypni butonin Nisje / Pushim. Tregohet koha e nisjes të vonuar që keni vendosur. Fillon numërimi mbrapsht i nisjes të vonuar. Simboli “_” pas kohës të nisjes të vonuar lëviz lart e poshtë në ekran.



Mund të shtohen rroba të tjera gjatë periudhës së nisjes së shtyrë.

Në fund të numërimit mbrapsht do të tregohet programi i zgjedhur. Simboli “ _ ” do të shfaqet dhe do të fillojë programi i zgjedhur.

Ndryshimi i periudhës të Nisjes së Shtyrë

Nëse doni ta ndryshoni kohën gjatë numërimit mbrapsht:

Shtypni butonin e Nisjes së Shtyrë Koha do të rritet me 1 orë çdo herë që shtypni butonin. Nëse doni ta ulni kohën e nisjes të vonuar, shtypni butonin e Nisjes të Vonuar vazhdimisht derisa të shfaqet koha e dëshiruar e nisjes të vonuar në ekran.

Anulimi i funksionit të Nisjes së Shtyrë

Nëse doni të anuloni numërimin mbrapsht të nisjes së shtyrë dhe të nisni menjëherë programin:

Vendoseni periudhën e Nisjes të Vonuar në zero ose rrotulloni çelësin e Zgjedhjes të Programit në çfarëdo programi. Kështu, funksioni i Nisjes së Shtyrë do të anulohet. Drita Përfundim/Anulim shkëlqen vazhdimisht.

Pastaj, përzgjidhni programin që doni të rivendosni sërish në punë. Shtypni butonin Nisje / Pushim për të nisur programin.

4.3.9 Nisja e programit

1. Shtypni butonin Nisje / Pushim për të nisur programin.
2. Drita e ndjekjes së programit që tregon nisjen e programit do të ndizet.



Nëse nuk niset asnjë program ose nuk shtypet asnjë buton brenda 1-10 minutash gjatë procesit të zgjedhjes së programit, makineria do të kalojë në metodën OFF. Ekрани dhe të gjithë treguesit fiken. Të dhënat e programit të zgjedhur do të shfaqen nëse shtypni butonin On / Off.

4.3.10 Kycja e derës

Ekziston një sistem në derën e ngarkimit së makinerisë që parandalon hapjen e derës në rastet kur niveli i ujit është i papërshtatshëm.

Drita LED "Door Locked" në panel ndizet kur dera është e kyçur.

4.3.11 Ndryshimi i përzgjedhjeve pasi programi të ketë nisur

